



Republika e Kosovës
Republika Kosovo – Republic of Kosovo
Kuvendi – Skupština – Assembly

Legjislatura V
Sesioni vjeshtor

Komisioni për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri

Mbledhja nr. 38/2015

Prishtinë, më 24.11.2015, në orën 11:30

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-303

P R O C E S V E R B A L
I M B L E D H J E S S Ë K O M I S I O N I T P Ë R Z H V I L L I M E K O N O M I K,
I N F R A S T R U K T U R Ë, T R E G T I D H E I N D U S T R I

Në mbledhje morën pjesë: Muhamet Mustafa, kryetar, Sasha Milosavljeviq, Raif Qela, Sala Berisha-Shala, Fatmir Rexhepi, Blerim Grainca dhe Duda Balje, anëtarë.

Munguan: Visar Ymeri, Besim Beqaj, Pal Lekaj dhe Enver Hoti, anëtarë.

Pjesëmarrës të tjerë: Agim Krasniqi, zëvendësministër dhe Milaim Aliu - MF; Agim Thaçi, Luan Morina dhe Fazile Bekteshi - MZHE; Hafiz Gara dhe Mevlyde Beqiri - MTI; Besnik Hajdari - MI; Musa Shabani, Azem Rexhaj dhe Haradin Gërvalla - KPMM; Ekrem Hoxha dhe Fatmir Gërvalla - ARKEP; Dritan Gjonbalaj dhe Shqipe Krasniqi – Sfishta - AAC; Avni Jashari dhe Adem Selishta - AKP; Enis Berisha dhe Shkëlzen Qorri – ARH; Përparim Pepaj - ZRRE; Arsim Tërrnava - AKK; Lumnije Murati - ZPRK; Dardan Abazi dhe Visar Berisha - INDEP; Lejla Selimi- OSBE; Fjolla Uka – KDI dhe Shefki Kastrati - NDI.

Stafi Mbështetës i Komisionit: Armend Ademaj dhe Besim Haliti.

Mbledhjen e kryesoi: Muhamet Mustafa, kryetar i Komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky

Rend i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së datës 10.11.2015;
3. Shqyrtimi i Raportit me amendamente të Projektligjit nr. 05/L-052 për Energjinë termike;
4. Të ndryshme.

Kryetari konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës së Komisionit dhe e hapi mbledhjen sipas rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Kryetari propozoi që pika e tretë e rendit të ditës: *”Shqyrtimi i Raportit me amendamente i Projektligjit nr. 05/L-052 për Energjinë Termike”*, të zhvendoset si pikë e katërt, sepse do të fusim si pikë të re apo të tretë: *”Shqyrtimi i Projektligjit nr. 05/L-071 për buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2016”*, për shkak se buxheti do të miratohet në procedurë të shpejtë dhe duhet t’i zëmë afatet për të paraqitur amendamentet e Komisionit.

Rendi i ditës u miratua me ndryshimin e propozuar nga kryetari.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 10.11.2015

Procesverbali i mbledhjes së datës 10.11.2015, u miratua pa vërejtje.

3. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 05/L-071 për buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2016

Kryetari tha se për shkak se buxheti do të miratohet në procedurë të shpejtë, pra me vendim të Kuvendit kështu është vendosur, ku deri më 9 dhjetor duhet të miratohet në lexim të dytë. Pra, ne duhet t’i zëmë afatet për të paraqitur amendamentet e Komisionit për buxhetin e vitit 2016, respektivisht për ministrinë që i kemi nën mbikëqyrje, si: Ministrinë e Zhvillimit Ekonomik, Ministrinë e Infrastrukturës dhe Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë, si dhe agjencitë e pavarura, që po ashtu janë nën mbikëqyrje, si: Autoriteti i Aviacionit Civil; Agjencia Kosovare e Privatizimit; Autoriteti Kosovar i Konkurrencës; Autoriteti Rregullativ i Komunikimeve Elektronike dhe Postare; Autoriteti Rregullativ i Hekurudhave; Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale dhe Zyra e Rregullatorit të Energjisë. Ju njoftoj se është ftuar edhe përfaqësuesi i Ministrisë së Financave, ku në mbledhje është i pranishëm zv.ministri Agim Krasniqi. Kryetari iu bëri thirrje që të prezantojnë vetëm kërkesat për projekte kapitale dhe ndonjë kërkesë shtesë që në mungesë të saj mund të rrezikojë funksionimin e atij institucioni.

Ekrem Hoxha (ARKEP), theksoi se përkundër disa dallimeve të cilat i kemi pasur në kërkesën tonë dhe në mundësitë buxhetore që i ka paraparë Ministria e Financave, kemi arritur në masën 95% ta harmonizojmë buxhetin tonë për vitin 2016. Meqenëse instruksioni ishte shumë i qartë, që sot të diskutohet vetëm për projektet kapitale, kërkojë vëmendjen e Komisionit për aq sa ka hapësirë ligjore t’i marrë për konsideratë kërkesat për projektet kapitale që kanë vlerë totale financiare kanë peshën prej 75 mijë eurove, e cila vlerë nuk është barrë e madhe për buxhetin e konsoliduar të Kosovës. Vendi ynë, në aspektin procedural, është afër për marrjen e kodit të internetit dhe kërkesa për marrjen e kodit të internetit nga mekanizmat ndërkombëtarë, i paraprin dhënies së konfiguracionit të rregullatorit e kapacitetit të domenit. Kostoja buxhetore është 20 mijë euro dhe të gjitha pikat e sektorit, përfshirë edhe këtë që sot e paraqita me shkrim, saktësisht kur ne i referohemi kësaj kërkesë. Një kërkesë e dytë përputhet me referimin që ka dhënë Komisioni funksional gjatë procesit të raportimit buxhetor, vendi i platformave për aplikimin online nga licenca me autorizime, ku rregullatori e ka hequr regjimin e licencave online, për të bërë hapin e fundit për të rritur transparencën në maksimum, detyrim

nga direktivat e BE-së dhe krijimi i platformës online për shërbimet për aplikim online. Projekti i tretë është blerja e ortopodeve nga Agjencia Kadastrale e Kosovës, ku kostoja e projektit është 25 mijë euro. Projekti i fundit është prej një modeli softuer që është online për krahasimin e tarifave. Ne të gjithë e dimë se konsumatorët në vendimmarrjen e shitblerjeve kanë nevojë për marrjen e informatave se cilat shërbime iu ofrojnë pako më të mira me çmimet krahasimtare e të tjera dhe është praktikë e rregullatorëve që ofron qasje neutrale të balancuar të informatave në një softuer, i cili i krahason tarifat dhe u mundëson qytetarëve marrjen e tyre të bazuar në tarifat të cilat janë në treg. Dhe në fund, në përmbyllje dua të siguroj Komisionin se të gjitha këto projekte janë në përputhje me rekomandimet dhe detyrat të cilat kanë dalë në rekomandimin që e ka miratuar Komisioni gjatë këtij viti.

Agim Thaçi (MZHE), theksoi se në ministrinë tonë, për vitin 2016, është pamundësuar realizimi i disa projekteve të cilat kanë qenë pjesë e buxhetit të vitit 2016 dhe jemi detyruar që për shkak të kufizimeve të cilat kanë ndodhur, vlera e të gjitha këtyre projekteve është 2 milionë e 950 mijë euro, sikur që është projekti i riparimit të lokomotivave të hekurudhave të Kosovës, projekt që është i kontraktuar nga vlera prej 1 milion e 200 mijë euro, janë ndarë vetëm 50 mijë euro. Gjithashtu, kemi edhe laboratorin e Shërbimit Gjeologjik të Kosovës, dhe për këtë qëllim, kemi planifikuar që në vitin 2016 ta ngremë laboratorin për analizat e shërbimit dhe gjërat e planifikuara kanë qenë 1 milion e 200 mijë euro, kurse ne kemi arrit ta ulim realisht jemi detyruar që ta ulim në 700 mijë euro. Gjithashtu, jemi detyruar ta ulim buxhetin për 200 mijë euro edhe te një projekt që financohet në bashkëpunim me Qeverinë e Zvicrës, i cili ka për qëllim trajtimin e ujërave të zeza dhe furnizimin me ujë të vendbanimeve rurale në Kosovë. Po ashtu, kërkesa e Infra Kosit që ka qenë blerja e një makine për rregullimin e binarëve dhe kjo makinë kushton 700 mijë euro. Në përmbyllje, e kam edhe një çështje tjetër. Aktualisht po punohet në dy dokumente, një dokument lidhur me fondin e eficiencës të energjisë dhe fondin për trajtimin dhe ngritjen e nivelit të teknologjisë informative në Kosovë. Të dy këto fonde janë në fazën e dërgimit në Qeveri. Këto dy fonde, nëse miratohen në Qeveri, do të kenë kosto.

Kryetari tha se i kisha lutur ministrinë të jenë më të arsyeshme, sepse ato është dashur të funksionojnë brenda Qeverisë dhe atje të diskutohen këto projekte, mirëpo ndonjë çështje e cila rrezikon ndonjë projekt që mund të jetë i arsyeshëm, është në rregull, por në përgjithësi ministrinë duhet të koordinojnë dhe të harmonizohen. Kuvendi i ka ato mundësi që t'i rishqyrtojë. Nuk them që nuk ka mundësi, mirëpo do të duhej apo do ishte më mirë që këto çështje atje të diskutohen më mirë.

Enis Berisha (ARH), tha se si sektor i vogël, nuk kemi projekte kapitale, prandaj që në fillim e thatë që nuk kemi çka të diskutojmë, atëherë nuk kam çka të shtoj më tutje.

Dritan Gjonbalaj (AAC), theksoi se nuk kemi ndonjë kërkesë. Disa kërkesa të vogla që i kemi pasur lidhur me kërkesën dhe kufirin e caktuar nga Ministria e Financave, i kemi sqaruar dhe kemi ardhur te një definicion i pajtuar i buxhetit në mes dy palëve .

Hafiz Gara (MTI), edhe pse në fillim e thatë që mos të diskutohen pagat në fjalë për agjencitë që rrezikohet funksionimi i tyre, mendoj që është temë që duhet të diskutohet, sepse janë pozicione të pakategorizuara në Agjencinë e Pronësisë Industriale, në Inspektoratin e Tregut, ku

të gjitha i kemi kalkuluar dhe i kemi dërguar tek Komisioni për Buxhet dhe është një vlerë shtesë prej 1 milion e 600 mijë eurosh, ku që të plotësohet funksionimi i këtyre agjencive, duhet këto mjete. Kjo është prioritet dhe kemi edhe implementimin e inspektoratit në nivelin qendror, ku është një mbetje në gjysmë të rrugës, që kemi planifikuar që t'i kemi 71 inspektorë dhe besoj nga ana jonë, këto ishin çështjet tona më emergjente.

Kryetari theksoi se për paga duhet të merret një qëndrim, që të shikohet një qëllim ku rrezikohet në aspektin institucional dhe shoqëror, ku mendoj që mund të ketë një fleksibilitet të Komisionit për Buxhet, por ne marrim pjesë në debat dhe amendamentet e tilla natyrisht që do t'i shqyrtojmë me kujdes edhe gjatë debatit në Kuvend. Por sot nuk kishim mundur për me marrë qëndrim për paga e për këto gjëra dhe neve si Komision nuk do ishim lëshuar në këto çështje.

Musa Shabani (KPMM), theksoi se shqetësimi ynë është tek pagat dhe mëditjet. Meqenëse ju thatë që këtë çështje mos ta ngremë, atëherë këtë çështje do ta shqyrtojmë dhe do ta ngremë tek Komisioni për Buxhet, pasi që është fjala për një sasi mjetesësh për t'i realizuar pozitat të cilat janë apo ekzistojnë dhe janë të lejuara, është fjala për 30 mijë e 300 euro.

Kryetari theksoi se çështjet që i diskutoi z. Hoxha, paraqesin një obligim ndërkombëtar dhe një forcim të pozicionit ndërkombëtar të sektorit të telekomunikimit në Kosovë dhe mendoj që duhet të trajtohen, sepse nuk janë ndonjë ngarkesë. Pra, edhe nëse nuk mundemi të gjitha, të paktën këto çështjet që lidhen me kodin, platformën, licencimin, çështja e Agjencisë së Kadastrës.

Agim Krasniqi (zëvendësministër i Financave), theksoi se për ne nuk pati asgjë risi nga temat e parashtruara, sepse janë çështje pothuajse të diskutuara brenda Qeverisë dhe pak a shumë janë diskutuar dhe janë marrë qëndrime. Ajo që ka mundur të përfshihet në buxhet, pak a shumë është përfshirë. E para, në ministri buxheti është harmonizuar dhe ministritë të gjitha e kanë pasur shumë të qartë që është harmonizuar buxheti dhe këtu nuk ka nevojë të paraqiten kërkesa. Kufijtë i kanë pasur dhe kanë pasur mundësi të gjitha të hyjnë në obligime dhe është dashur të hyjnë në obligime, vetëm aq sa kanë buxhet. Asnjë planifikim mbi buxhet apo mbi kornizën buxhetore, nuk është e nevojshme të diskutohet, që të mos t'ju marrim kohë edhe juve, sepse është edhe shkelje e ligjit. Pra, nuk bën të hyjmë në obligime, pa pasur buxhet. Ne jemi të gatshëm që çdo rekomandim dhe çdo dokument që e bëjnë deputetët, ta përfshijmë, por unë po flas në kuptimin e Qeverisë, në nivel të ministrive të tjera përkatëse. E dyta, tek çështja e punësimit, kemi pasur problem dhe kemi probleme. Tash për tash, nuk është ajo që është aprovuar, sepse nuk mund të plotësohen të gjitha vendet e punës, për shkak të kufizimeve të cilat i kemi në buxhet. Të gjithëve iu kemi njoftuar dhe pak a shumë, punësimi mbetet i nivelit të qershorit, edhe në vitin e ardhshëm. Në momentin që na krijohet hapësirë fiskale, do të mund të plotësohen vendet e lira të punës. Tek çështja e këtyre projekteve, të cilat i përmendi z. Ekrem Hoxha, besoj që bashkërisht mund të ulemi dhe t'i shikojmë. Për këto ndërmarrje publike duhet mësuar që buxheti i shtetit mund t'i ndihmojë në ndonjë rast të veçantë, por jo gjithëherë prej buxhetit, i cili përkrah projekte të caktuara. Për çështjen e punësimit, dhe KPMM-në, për momentin është kaq kapacitetit i Kosovës. Asnjëherë ju nuk do të dëgjoni, sikurse që dëgjojmë ne, që dikush do të vijë dhe t'ju thotë se i kam nja 10 punëtorë të administratës dhe nuk po di çka t'ju bëjë, por kanë për të ardhur të kërkojnë një pozitë e cila

është mjaft e rëndësishme. Po të fillojmë nga ministrinë, nëse pyesim sekretarin, thotë se e kam një pozitë mjaft të rëndësishme pa plotësuar, por nuk tregon që i ka 10 zyrtarë të cilët nuk e dinë se për çka vijjnë në punë. Pra, të filloni t'i riorganizoni ministrinë dhe agjencitë e juaja.

Kryetari tha se e përkrah zëvendësministrin plotësisht lidhur me punësimin dhe të bëni të gjitha përpjekjet për rikonstruktiv brenda institucionit tuaj, sepse Kosova ka krijuar një administratë shumë të madhe të shërbyesve publikë dhe buxheti është shumë i ngarkuar. Unë po them se, në përgjithësi, nuk do të thotë se kjo mund të jetë e saktë për KPMM-në, por edhe KPMM-së po i bëjmë ftesë që të ulët Bordin dhe të shikoni rishikimin, riorganizimin me punëtorët të cilët i keni.

Raif Qela, desha vetëm pak lidhur me kërkesat e ARKEP-it, për njërin prej tyre mendoj se buxheti ishte dashur të ndryshojë pikërisht lidhur me kodin e internetit i cili i paraprin edhe menaxhimit të domenit. Kjo është një çështje e cila në një fushë të veçantë arrihet pavarësi edhe neve këtë duhet ta bëjmë patjetër, për të tjera kërkesa nuk jam shumë i sigurt. Lidhur me kërkesat e Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, nuk jam i sigurt, por është bërë një kërkesë apo amendament lidhur me kërkesën e Infra Kosit për lokomotivat ekziston, por ju duhet ta hulumtoni se a është shkruar si amendament a jo.

Fatmir Rexhepi, theksoi se do të them diçka në parim që vazhdon me politikat dhe strategjinë që pastaj po sjellin problem zhvillimor në rajone të caktuara. Këtë debat e kemi pasur edhe më herët në Kuvend dhe ky debat ende vazhdon. Kjo politikë vazhdon ende edhe në Qeveri, edhe në Kuvend, së paku kur i sheh këto tabela deri në vitin 2018. Pra, ka projekte të cilat ndikojnë në zhvillimin ekonomik të vendit dhe nuk janë në pajtim me këto politika. Po të lexoni për rehabilitimin e rrugëve rajonale dhe këto tjerat, këtu askund nuk e keni përfshirë rrugën rajonale, bie fjala, Gjilan – Prishtinë. Zakonisht, investimet që disa vite kanë shkruar si p.sh. në rajonin e Shtimes dhe çfarë politikash keni bërë. Pra, edhe unë e di, në gjeografi, që Drenasi ka qenë qendër e Kosovës, e jo Shtimja. Sa i përket bashkëfinancimit me komuna, është përfshirë, ndërsa ndërtimi i rrugëve të reja nuk figuron në asnjë projekt, së paku në këto tabela që i kemi përpara. Tek ndërtimi i autostradës, e di që është folur lidhur me këtë projekt. Unë jam dakord që të përfundojnë edhe projektet e kësaj rajonaleje në Mitrovicë, për Pejë, por është bërë politikë jo e drejtë, sepse është lënë anash një rajoni i tërë i Kosovës pas dore, pa u përfshirë, por nuk keni qare pa i ndërtuar, deshi apo nuk deshi kjo Qeveri, por do të ndërtohen diku mbas pesë vitesh apo gjashtë vitesh, mirëpo kemi diferencë kohore që 15 vite që nuk është filluar asgjë. Sa ndikon kjo në politikat zhvillimore tek një rajon i caktuar, duke përfshirë këtu atë pjesën lindore. Po ashtu desha t'ua tërheq vërejtjen se janë bërë gabime dhe vazhdojnë të bëhen gabime. Si orientim politik, së paku është dashur të shënohet një emër këtu që të mashtrohen ata qytetarë se ndoshta në vitin 2018 do të fillojë ndonjë projekt i një ndërtimi të ndonjë rajonaleje, sepse po bëjmë politikë dhe këtu nuk figuron. Pra, si të bindet rajoni i Gjilanit se do të ndërtohet diçka apo ka për t'u bërë diçka. është folur në televizion, por duhet të dilet me dokument dhe unë desha pak t'ua tërheq vërejtjen.

Blerim Grainca, theksoi se këtë buxhet e sheh si buxhet të mundësive, jo si buxhet i plotësimi të dëshirave. Tek investimet kapitale, janë diku rreth 80% të investimeve kapitale të kontraktuara në mënyrë paraprake, që i bie se jemi duke paguar borxhe ose duke larë borxhe. Pra, krejt hapësira për ndryshime është ajo 15 %, i cili ka ngelur për ta ridestinuuar tek

investimet kapitale. Ju kisha lutur që këtë pjesën për buxhet dhe për rritje buxhetore të agjencive dhe të ministrive, si Komision, ta përcjellim edhe kërkesën për rritjen e performancës, për arsye se ky Komision, në të kaluarën, por edhe tash, ka shumë vërejtje për performancën e shumë agjencive për rritjen e bordeve dhe për performancën e disa ministrive. Prandaj, sugjerimi im është që nga ky takim të dilet me një ide, që përveç rritjes së buxhetit, të përfshihet edhe performanca e këtyre agjencive. Pyeti zëvendësministrin për buxhetin e MTI-së se a është e mundur që brenda këtij pesë milionëshi të hyjë edhe buxheti i fondit të garancive kreditore që është në MTI, pra desha ta di, a është brenda këtij pesë milionëshi, për shkak se në njërin nga takimet e kaluara, MTI-ja nuk ka dhënë përgjigje lidhur me këtë.

Sala Berisha- Shala, ne e kemi thirrur këtë takim veç për të dëgjuar, sepse mundësitë janë të pakta për ndërhyrje nga ana jonë. Unë do të ndalem shumë shkurt tek një rast. Më duket se ARKEP-i e përmendi blerjen e arkofotove nga Agjencia Kadastrale e Kosovës. Për mua është disi e paqartë, brenda mekanizmave qeveritarë të cilët e kanë të njëjtin buxhet, financohen prej të njëjtit buxhet për të bërë blerjen dhe shitjen në mes veti, pra më duket e pakuptimtë dhe e palogjikshme. Është mirë që ne t'i kemi parasysh, u përmenden këtu pozita të cilat janë paraparë dhe janë hequr. Është mirë që ato pozita të cilat janë në plotësimin e obligimeve ndërkombëtare, të kemi një mirëkuptim që t'i plotësojmë. Me fjalë të tjera, pozita të cilat e bëjnë funksional institucionin. Nga Ministria e Zhvillimit Ekonomik u paraqit një problem për laboratorin gjeologjik. Lidhur me këtë, mendoj se laboratori është vetëm njëri nga problemet e Shërbimit Gjeologjik të Kosovës. Ne e dimë se Shërbimi Gjeologjik i Kosovës është formuar para dy tri vitesh dhe nuk është fare në funksion. Pra i ka vetëm pesë gjashtë pozita, por për t'u funksionalizuar duhet së paku 25 pozita të jenë aktive. Unë nuk e shoh në asnjë projektbuxhet që është bërë diçka apo është ofruar një zgjidhje e tillë e hapësirës së punës për Shërbimin Gjeologjik të Kosovës. Mandej, është një problem tjetër jashtëzakonisht i madh te Shërbimi Gjeologjik, i cili ka pasur mjetet e laboratorët e caktuar jo vetëm laboratori i cili është në Mitrovicë, por edhe laboratorët tjerë dhe ato kanë mbetur pa u futur në funksion. U përmend që ka shumë pozita, por në njërin anë ka pozita të cilat mungojnë, në anën tjetër ka pozita tepërta. Sigurisht, që me riorganizim të Qeverisë, duhet t'i shqyrtojnë këto pozicione dhe ta bëjnë balancën e tyre.

Kryetari theksoi se sa i përket punësimit, kërkesa jonë e parë është që të gjitha agjencitë e pavarura dhe të gjitha ministrinë në vend, që kërkojnë ta ngritin punësimin, të shqyrtojnë të gjitha mundësitë e rishikimit edhe përshkrimeve të reja të atyre vendeve të punës që i kanë aktualisht. Ajo që është e domosdoshme, të mbështesim projektet lidhur me çështjet ndërkombëtare nga ARKEP-it, të shikojnë lidhur me atë se mos ka pasoja laboratori gjeologjik në aspektin e zhvillimit, dhe gjithashtu standardizimi, jo për të punësuar njerëz aty, por standardizimi të na bindë ne, se ka nevojë për buxhet dhe tani e shqyrtojmë në Kuvend dhe do t'i mbështesim.

Pas debatit, Komisionit propozoi këto amendamente për Komisionin për Buxhet dhe Financa, si vijon:

Amendamenti 1

Në organizatën buxhetore “Ministria e Zhvillimit Ekonomik”, me kod organizativ 213, nën-programi “Shërbimi Gjeologjik i Kosovës” në projektin kapital “Laboratori IGJK”, shuma prej “550.000 euro”, ndryshohet në “1.247.607 euro”.

Amendamenti 2

Në organizatën buxhetore “Ministria e Tregtisë dhe Industrisë” me kod organizativ 204, të shtohet nënprogrami i ri “Agjencia Kosovare për Standardizim” dhe projekti i ri kapital “Krijimi i Njesisë për Certifikim”, në shumën prej 17.620 euro.

Amendamenti 3

Në organizatën buxhetore “Autoriteti Rregullativ i Komunikimeve Elektronike dhe Postare” me kod organizativ 113, të shtohet projekti i ri kapital “Krijimi i Njesisë për menaxhimin e krye-domenit shtetëror të internetit” në shumën prej 20.000 euro.

4. Shqyrtimi i Raportit me amendamente i Projektligjit nr. 05/L-052 për Energjinë termike

Kryetari tha për këtë projektligj, kemi një grup pune, ku raportues është z. Fatmir Rexhepi. Pastaj ia dha fjalën zotit Rexhepi për të paraqitur raportin me amendamente.

Fatmir Rexhepi, tha se pasi që ky raport është shtyrë nga mbledhja e fundit, për shkak se grupi i punës nuk ka mundur të mbledhet. Ju njoftoj se grupi është mbledhur më 20.11.2015 dhe në prani të ekspertit dhe OJQ INDEP, i ka hartuar amendamentet, të cilat do t'i arsyetoj një nga një.

Amendamenti 1

Neni 3, pas nënparagrafit 1.2, shtohet një nënparagraf i ri 1.3, si vijon:

1.3. Çmimi i parregulluar - çmimi që i ngarkohet konsumatorit për ofrimin e shërbimeve standarde, siç përcaktohet në kontratë.

U miratua nga Komisioni.

Amendamenti 2

Neni 3, nënparagrafi 1.9, riformulohet si vijon:

1.9. Furnizimi publik – furnizimi i konsumatorëve fundorë me energji termike, me tarifa të rregulluara në pajtim me këtë ligj.

Në tërë nenin 3, fshihet fjala “nënkupton”.

U miratua nga Komisioni.

Amendamenti 3

Neni 13, nënparagrafi 1.15, ndryshohet si vijon: 1.15. Konsumator me prioritet furnizimi-konsumatori që ka prioritet në furnizim me energji termike”.

Kryetari tha se ky amendament duhet të ndryshohet, në mënyrë që mos të ketë diskriminim në prioritete, andaj propozoi amendamentin si vijon: Neni 3, nënparagrafit 1.15, i shtohet teksti si vijon: “si dhe institucionet tjera që mund të rregullohen me akt nënligjor”.

Komisioni përkrahu propozimin e kryetarit.

Amendamenti 4

Neni 3, nënparagrafi 1.27 ndahet në dy nënparagrafë të rinj, 1.27 dhe 1.28, si vijon:

1.27. Rrjeti i shpërndarjes së energjisë termike - sistemi i tubacioneve, që transportojnë dhe shpërndajnë energjinë termike nga prodhuesi, deri tek nënstacionet termike (prej vendit të matjes së energjisë termike të pranuar, deri tek vendi i matjes së energjisë termike për furnizim, respektivisht nënstacionet termike dhe njehsorëve të energjisë termike).

1.28. Rrjeti sekondar i energjisë termike - sistemi i tubacioneve që shpërndajnë energjinë termike nga vendi i matjes së energjisë termike për furnizim, respektivisht nënstacioni, si dhe pajisjet përcjellëse tek konsumatori fundor.

Raif Qela, propozoi që nënparagrafi 1.28 të riformulohet si vijon:

1.28. Rrjeti sekondar i energjisë termike - sistemi i tubacioneve si dhe pajisjet përcjellëse që shpërndajnë energjinë termike nga vendi i matjes së energjisë termike për furnizim, respektivisht nënstacioni, deri tek konsumatori fundor.

Komisioni përkrahu propozimin e z. Qela.

Amendamenti 5

Neni 3, nënparagrafi 1.30, fjala “mbyllur” zëvendësohet me “drejtpërdrejtë”.

Raif Qela, ishte kundër këtij propozimi dhe kërkoi që të mbetet sikur në projektligj.

Komisioni nuk e përkrahu propozimin e z. Qela.

Amendamenti 6

Neni 4, pas paragrafit 2, shtohet një paragraf i ri 3, si vijon:

3. Komuna është përgjegjëse për hartimin e planeve dhe projekteve për zhvillimin dhe sistemin e përdorimit të energjisë termike.

Raif Qela, propozoi që të ndryshohet ky amendament, në mënyrë që të saktësohet më mirë ky paragraf i shtuar.

Fatmir Rexhepi, propozoi riformulimin e amendamentit 6 si vijon:

Neni 4, pas paragrafit 2, shtohet një paragraf i ri 3, si vijon:

3. Komuna është përgjegjëse për hartimin e planeve dhe projekteve për zhvillimin e sektorit të energjisë termike brenda territorit të saj.

Komisioni përkrahu propozimin e z. Rexhepi.

Amendamenti 7

Neni 10, teksti “në pajtim me nenin 46 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë”, zëvendësohet me tekstin “në pajtim me Ligjin për Rregullatorin e Energjisë”.

U miratua nga Komisioni.

Amendamenti 8

Neni 14, paragrafi 2, fshihet fjala “mund të”.

U miratua nga Komisioni.

Amendamenti 9

Neni 15, në paragrafit 1, fjala “tilla”, zëvendësohet me “shpërndarjes për energjinë termike”.

Raif Qela, propozoj që ky amendamenti të përmirësohet si vijon:

Neni 15, në paragrafit 1, fjala “tilla”, zëvendësohet me “shpërndarjes së energjisë termike”.

Komisioni e përkrahu propozimin e z. Qela.

Amendamenti 10

Neni 15, nënparagrafi 2.3, i shtohen fjalët “dhe urban të komunës”.

U miratua nga Komisioni.

Amendamenti 11

Neni 15, nënparagrafi 2.4, ndryshohet si vijon:

2.4. Parashikon kërkesat për energji termike në harmoni me projektet e veta për zhvillim ekonomik dhe urban të komunës.

U miratua nga Komisioni.

Amendamenti 12

Neni 15, nënparagrafi 3.1, i shtohet teksti “dhe urban të komunës”.

U miratua nga Komisioni.

Amendamenti 13

Neni 15, nënparagrafi 3.3, riformulohet si vijon:

3.3. Bashkëpunon me ministritë dhe komunat në përgatitjen e planeve, programeve dhe strategjive zhvillimore.

U miratua nga Komisioni.

Amendamenti 14

Neni 15, pas paragrafit 8, shtohet një paragraf i ri 1.9 si vijon:

9. Operatori i Sistemit të Shpërndarjes obligohet të bëjë instalimin e pajisjeve matëse të ngrohjes, të cilat mundësojnë leximin e rregullt të konsumit të energjisë

U miratua nga Komisioni.

Amendamenti 15

Neni 16, paragrafi 2, fshihet fjala “konfidenciale”.

U miratua nga Komisioni.

Amendamenti 16

Neni 18, teksti “në pajtim me nenin 46 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë”, zëvendësohet me “në pajtim me Ligjin për Rregullatorin e Energjisë”.

U miratua nga Komisioni.

Amendamenti 17

Neni 25, paragrafi 1, shtohet nënparagrafi i ri 1.4, me tekstin si vijon: 1.4. Ka siguruar qasjen në vendosjen e pajisjes matëse të ngrohjes.

Raif Qela, propozoi që amendamenti 17 të riformulohet si vijon:

Neni 25, paragrafi 1, shtohet nënparagrafi i ri 1.4, me tekstin si vijon:

1.4. Ka siguruar qasje për vendosjen e pajisjes matëse të ngrohjes.

Komisioni e përkrahu propozimin e z. Qela.

Amendamenti 18

Neni 25, në fund të tekstit të paragrafit 3, shtohet teksti si vijon: ”dhe ka arsyeshmëri ekonomike”.

U miratua nga Komisioni.

Amendamenti 19

Neni 25, paragrafi 5, riformulohet si vijon:

5. Nëse konsumatori bën kyçje ilegale apo ndërhyrje të paautorizuar në sistemin e energjisë termike, bart përgjegjësi në pajtim me aktet nënligjore përkatëse.

Raif Qela, propozoj që ky amendament të përmirësohet si vijon:

Neni 25, paragrafi 5, riformulohet si vijon:

5. Nëse konsumatori bën kyçje ilegale apo ndërhyrje të paautorizuar në sistemin e energjisë termike, atëherë ai bart përgjegjësi në pajtim me aktet ligjore përkatëse.

Komisioni e përkrahu propozimin e z. Qela.

Amendamenti 20

Neni 25, pas paragrafit 7, shtohet paragraf i ri 8, si vijon:

8. Konsumatori është i detyruar të sigurojë vendosjen e pajisjeve matëse të ngrohjes në hapësirat e brendshme, të banimit apo komerciale, për lexim nga distanca dhe qasje të lirë të punëtorëve të ndërmarrjes së energjisë termike për kontrollimin dhe mirëmbajtjen e këtyre pajisjeve.

U miratua nga Komisioni.

Amendamenti 21

Neni 27, ndryshohet paragrafi 3, si vijon:

3. Furnizuesi mund ta bëjë pezullimin e përkohshëm të shërbimit për konsumatorin, nëse konsumatori nuk i përmbush obligimet që i ka në kontratë, duke përfshirë riparimin e problemeve teknike që kanë ndodhur në rrjet dhe të pajisjeve matëse të ngrohjes brenda hapësirave të konsumatorit apo pajisjet e instaluar të konsumatorit.

Raif Qela, propozoi që ky amendament të përmirësohet si vijon:

Neni 27, ndryshohet paragrafi 3, si vijon:

3. Furnizuesi mund ta bëjë pezullimin e përkohshëm të shërbimit për konsumatorin, nëse konsumatori nuk i përmbush obligimet që i ka në kontratë, duke përfshirë riparimin e problemeve teknike që kanë ndodhur në rrjet dhe të pajisjeve matëse apo pajisjeve tjera të ngrohjes të instaluar brenda hapësirave të konsumatorit.

Komisioni e përkrahu propozimin e z. Qela.

Amendamenti 22

Neni 27, pas paragrafit 7, shtohet një paragraf i ri 8, si vijon:

8. Në rast të moskompensimit sipas paragrafit 7 të këtij neni, pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në Zyrën e Rregullatorit për Energji sipas Ligjit të Rregullatorit për Energji.

U miratua nga Komisioni.

Amendamenti 23

Neni 30, ndryshohet si vijon:

1. Furnizimi me energji termike matet me pajisje matëse, ndërsa instalimi, operimi, mirëmbajtja apo zëvendësimi i pajisjeve për matje, bëhet në pajtim me Kodin e Matjes.

2. Energjia termike e shfrytëzuar nga konsumatori llogaritet me pajisje për matje që është pronë e Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes.

3. Tek konsumatorët fundorë individualë - objekte individuale të banimit dhe komerciale - pajisjet për matje duhet të vendosen në pikën e furnizimit, sa më afër kufirit të pronës së konsumatorit.

4. Tek konsumatorët fundorë në ndërtesa kolektive - objekte kolektive të banimit dhe komerciale, pajisjet për matje duhet të vendosen në hapësirat e secilit konsumator, nëse është teknikisht e mundur dhe leximi duhet të bëhet pa pasur qasje në hapësirat e banimit të konsumatorit.

5. Kufiri i pronës, përgjegjësia për objektet termike, vendi për vendosjen e pajisjeve matëse dhe të gjitha aspektet tjera të matjes përcaktohen me Kodin e Matjes.

U miratua nga Komisioni.

Amendamenti 24

Titulli i nenit 32, ndryshohet si vijon: “Mbikëqyrja dhe inspektimi administrativ”.

U miratua nga Komisioni.

Amendamenti 25

Neni 35, paragrafi 5, ndryshohet si vijon:

5. Furnizuesi përgatit dhe propozon kontratë komerciale për furnizim me energji termike të konsumatorit, sipas dispozitave të këtij neni dhe nenit 20 të këtij ligji dhe mban regjistrin e konsumatorëve dhe të të gjitha kontratave valide.

U miratua nga Komisioni.

Amendamenti 26

Neni 35, paragrafi 6, fshihet referenca “paragrafit 4”.

U miratua nga Komisioni.

Amendamenti 27

Neni 35, paragrafi 7, ndryshohet si vijon:

7. Për konsumatorët që nuk kanë pajisje matëse, deri në instalimin e pajisjeve sipas paragrafit 1 të këtij neni, aplikohet tarifa normative.

U miratua nga Komisioni.

Amendamenti 28

Neni 36, paragrafi 2, ndryshohet si vijon:

2. Ministria dhe Zyra e Rregullatorit për Energji, për zbatim të këtij ligji, do të nxjerrin aktet nënligjore në afat prej 12 (dymbëdhjetë) muaj nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

Kryetari propozoi që afati për nxjerrjen e akteve nënligjore prej dymbëdhjetë muajsh është shumë i gjatë dhe e propozoi që ky afat të ndryshohet në “ 6 (gjashtë) muaj” .

Komisioni përkrahu propozimin e kryetarit.

Pas miratimit të amendamenteve një për një, Komisioni njëzëri nxori këtë

Përfundim

- 1. Miratohet Raporti me amendamente i Projektligjit nr.05/L-052 për Energjinë termike.*
- 2. Raporti t’u procedohet Komisioneve të përhershme, sipas procedurës së rregullt.*

5. Të ndryshme

Çështje vijuese

Mbledhja përfundoi në orën 13:00.

E përqatiti:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit.

Kryetar i Komisionit,

Muhamet Mustafa